



“Meridian Express” shpall konkurs për plotësimin e vendit të punës:

Udhëheqës/e i/e Financave

Përgjegjësitë kryesore:

- Përpilon, menaxhon dhe monitoron zbatimin e strategjisë, politikës dhe procedurave të Departamentit të Financave;
- Organizon, drejton dhe mbikëqyr funksionet e kontabilitetit, raportimit financiar, kontrollit, thesarit dhe tatimeve si dhe përkujdeset për lehtësimin e operacioneve ditore;
- Ndërton sisteme financiare dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm që mbështesin drejtimin strategjik të kompanisë dhe parandalojnë rrezikun financiar;
- Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë, transaksionet dhe parametrat tjerë financiar që tregojnë performancën financiare të kompanisë;
- Ndihmon në parashikimin dhe mbikëqyrjen e investimeve kapitale, si dhe shqyrton praktikrat për të rritur të hyrat dhe ulur kostot;
- Identifikon, analizon dhe monitoron parametrat e risqeve financiare për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike;
- Raporton rezultatet financiare për palët e brendshme dhe të jashtme dhe ndihmon departamentet përmes analizave financiare, informacionit menaxherial dhe rekomandimeve;
- Përgatit, kontrollon dhe mbikëqyr rrjedhën e proceseve të përgatitjes së raporteve dhe pasqyrave financiare periodike dhe vjetore;
- Koordinon dhe aprovon ndryshime me qëllim të përmirësimeve në sistemet financiare të kompanisë;
- Mbikëqyr veprimtarinë financiare të kompanisë dhe sistemin e përpunimit të të dhënave financiare të kompanisë;
- Mbikëqyr dhe menaxhon procesin e planifikimit të buxhetit dhe parashikimeve financiare në koordinim me departamentet tjera dhe përcjellë realizimin e tij në vazhdimësi;
- Përkujdeset se të gjitha praktikrat financiare janë në pajtueshmëri me legjislacionin dhe rregullat në fuqi;
- Menaxhon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave në pajtueshmëri me kërkesat e auditorëve dhe agjencive qeveritare;
- Mban marrëdhënie profesionale me institucionet financiare, kontraktorët dhe palët tjera të jashtme;
- Mbikëqyr, koordinon dhe këshillon personelin brenda Departamentit të Financave;

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Ekonomi;
- Kualifikim profesional në Kontabilitet (SCAAK, ACCA apo ndonjë shoqatë tjetër);
- Minimum tri (3) vite përvojë pune në fushën e menaxhimit të financave;
- Aftësi udhëheqëse dhe të delegimit të përgjegjësive;
- Kreativitet dhe iniciativë për ide të reja dhe përmirësime të proceseve të punës;
- Aftësi për formulimin e strategjive financiare, raporteve financiare, politikave të kontabilitetit dhe procedurave të kontrollit në pajtueshmëri me objektivat e kompanisë dhe konform legjislacionit në fuqi;

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në në apliko@meridianexpress.com dhe duke cekur në subjekt qartë pozitën për të cilën aplikojnë.

Data e fundit për aplikim është data **15 Prill 2019**.

